



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 30 date 13.6.2022**

**KODI I SJELLJES DHE I PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE TË KËSHILLTARIT BASHKIAK**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 13.6.2022, në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9 pika 1.1, germa “b” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, model-rregullore të hartuar në kuadër të projektit “Bashki të Forta”, i zbatuar nga Helvetas dhe i financuar nga Qeveria Zvicerane, me propozim të Kryetares së Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e Kodit të sjelljes dhe parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Shkodër dhe Sekretari i Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Brisela KADIJA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lesha**

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 20.6.2022

# **KODI I SJELLJES DHE I PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË KËSHILLTARIT BASHKIAK**

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Objekti dhe qëllimi**

1. Kodi i Sjelljes dhe i Parandalimit të Konfliktit të Interesit të Këshilltarit Bashkiak, i referuar me poshte si “Kodi”, është tërësia e parimeve e rregullave, të miratuara nga Këshilli Bashkiak, që shërben si udhërrëfyes për këshilltarin bashkiak, në mënyrë që ai të mbajë dhe ushtrojë standartet e duhura të sjelljes dhe veprimeve gjatë ushtrimit të funksionit publik, duke respektuar legjislacionin në fuqi, etikën dhe parandaluar rastet e konfliktit të interesit.
2. Kodi bazohet në 7 parimet e jetës publike, të cilat përcaktojnë standartet më të larta për personat që mbajnë funksione publike dhe synon të vërë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë këshilltari bashkiak.
3. Kodi zbatohet në të gjitha rastet kur këshilltari vepron, pretendon se vepron, apo jep përshtypjen se vepron, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Bashkiak, përfshirë komentet, bisedat e folura, letrat e shkruara, si dhe përdorimin e medias elektronike dhe rrjeteve sociale.

#### **Neni 2**

##### **Baza ligjore**

Kodi është një akt nënligjor që miratohet nga Këshilli Bashkiak, në bazë dhe për zbatim të:

1. Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8137 datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”;
3. Ligji nr. 8548 datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”;
4. Ligji nr. 44 datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
5. Ligji 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

6. Ligji nr. 152 datë 17.10.2013 “Për Nëpunësin civil”;
7. Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”;
8. Ligji nr. 8480, date 27.5.1999, “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”Ligji nr. 107 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”;
9. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
10. Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;
11. Ligji Nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
12. Ligji nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
13. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
14. Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Bashkiak

### Neni 3

#### **Parimet e përgjithshme të funksionimit të Këshillit**

1. Parimet e funksionimit të Këshillit janë:

- a) Interesi publik - Këshilltarët duhet të veprojnë vetëm në bazë të interesit publik dhe jo atij personal. Ata nuk duhet të përdorin pozicionin si këshilltar për të përfituar për veten. Këshilltari është ruajtësi i interesit publik dhe prandaj sjellja, veprimet dhe vendimet e tij duhet të reflektojnë në çdo rast këtë përgjegjësi.
- b) Integriteti - Këshilltarët duhet të shmangin vënien e vetes nën detyrime ndaj njerëzve dhe organizatave që mund të përpiqen në mënyrë të papërshtatshme t'i influencojnë ata në punën dhe vendimet e tyre. Këshilltarët duhet të mos veprojnë ose marrin vendime me qëllim që të marrin përfitime financiare ose materiale për veten dhe familjarët e tyre. Ata duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi gjatë procesit vendimmarrës.
- c) Objektiviteti - Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe në bazë të meritës, duke përdorur evidencat më të besueshme dhe pa diskriminime apo paragjykime.
- ç) Përgjegjshmëria - Këshilltarët janë përgjegjës ndaj zgjedhësve të tyre dhe publikut në përgjithësi për sjelljet, veprimet dhe vendimet e tyre.
- d) Transparenca - Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime në mënyrë të hapur dhe transparente. Informacioni nuk duhet t'i mbahet publikut, vetëm nëse ka arsye të qarta dhe ligjore për ta bërë këtë.

dh) Ndershmëria - Këshilltarët duhet të jenë të ndershëm dhe të besueshëm gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

e) Liderhipi - Këshilltarët duhet të demonstrojnë këto parime në sjelljen e tyre. Ata duhet të promovojnë në mënyrë aktive dhe të mbështesin në mënyrë solide këto parime, si dhe të jenë të gatshëm të sfidojnë sjelljet që bien ndesh me këto parime, kudo dhe kurdoherë që të ndodhin.

f) Barazia dhe mosdiskriminimi – Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime duke mundësuar akses dhe mbështetje të barabartë ndaj qytetarëve në shërbime nëpërmjet integritetit gjinor dhe gjithëpërfshirjes në programet e Bashkisë.

2. Këshilli inkurajon shoqërinë civile për monitorimin e zbatimit të parimeve të jetës publike nga ana e Këshillit dhe Këshilltarëve, dhe shqyrton në Mbledhjen e Këshillit raportin përkatës të shoqërisë civile. Mbi bazën e këtij raporti Këshilli miraton masat për zbatimin e parimeve të jetës publike nga Këshilli dhe Këshilltarët.

## **Neni 4**

### **Përkufizime**

Në këtë Kod, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të këshilltarit bashkiak, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

2. “Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive” është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën këshilltari bashkiak vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së këshilltarit.

3. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) “konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të këshilltarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;

b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të këshilltarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë:

c) "konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të këshilltarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse këshilltari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

ç) "konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;

d) "konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

4. "Zotërim aktiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave, që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital.

5. "Zotërim pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është gjendja, në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta e detyrime të tjera të domosdoshme, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

6. "Person i lidhur me një këshilltar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me këshilltarin, në bazë të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

## **Neni 5**

### **Detyrimet e Këshilltarit Bashkiak**

Detyrimet e Këshilltarit Bashkiak janë:

1. Këshilltari duhet të veprojë në mënyrë të ndershme dhe të përkushtuar në interes të publikut. Ai duhet t'i qëndrojë besnik përcaktimit të rolit të tij në Kushtetutë dhe në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si përfaqësues i komunitetit.

2. Këshilltari nuk duhet të përdorë pozicionin e tij për të siguruar përfitime personale dhe avantazhe për vete apo dikë tjetër, apo për të shmangur disavantazhet për vete apo dikë tjetër. Kjo vlen për gjithë kohën apo mandatin e tij si këshilltar. Këshilltari nuk duhet të përdorë mandatin e tij për përfitime personale apo interesin privat për vete apo dikë tjetër;

3. Këshilltari nuk duhet të sillet apo veprojë në asnjë rast në mënyrë të atillë që konsiderohet si prishje e reputacionit të tij apo institucionit që ai përfaqëson. Këshilltari ndërgjegjësohet që sjelljet dhe veprimet e tij të papërshtatshme, si në jetën publike dhe atë private, mund të kenë një impakt në reputacionin dhe imazhin e Këshillit.

Këshilltari nuk duhet të bëjë kritika jo të sakta dhe jo të drejta në drejtim të Këshillit në publik, pasi ato mund të konsiderohen si cënim i autoritetit ligjor, moral e përfaqësues të

Këshillit. Këshilltari nuk duhet t'i transmetojë elektoratit të tij ose të postojë në median sociale komente të papërshtatshme, të cilat mund të dëmtojnë imazhin e Këshillit;

4. Këshilltari nuk duhet të bëjë kompromis në paanshmërinë e tij apo kujdo që punon për Këshillin. Këshilltari nuk duhet të influencojë apo bëjë presion tek Sekretari i Këshillit apo punonjësit e Sekretariatit për të vepruar në mënyrë të njëanshme apo partiake. Këshilltari nuk duhet të kërkojë nga punonjësit e administratës së Këshillit ta ndihmojnë për çështje të tyre politike apo çështje të interesit privat. Këshilltari nuk duhet të ofrojë incentiva për të arritur qëllimet e tij politike apo private, apo të kërcënojë dikë nëse nuk bën kompromis me qëllimet e tij. Këshilltari nuk duhet të bëjë kompromise me paanshmërinë e punonjësve të administratës së Këshillit.

5. Këshilltari duhet të veprojë me mendje të hapur dhe objektivitet gjatë mbledhjeve të Këshillit apo në çështje që kanë të bëjnë me interesin publik. Këshilltari gjatë procesit vendimmarrës duhet të veprojë në mënyrë të drejtë dhe të marrë në konsideratën e duhur interesin publik.

6. Këshilltari nuk duhet të nxjerrë informacionin e cilësuar si konfidencial. Këshilltari duhet të trajtojë çështjet e diskutuara në mbledhjet e mbyllura të Këshillit dhe komisioneve, si të tilla. Këshilltari nuk duhet të japë informacion konfidencial, përveç në rastet kur këshilltari ka pëlqimin e dikujt të autorizuar për ta dhënë informacionin apo kur dhënia e informacionit lejohet apo kërkohet me ligj.

7. Këshilltari nuk duhet të pengojë askënd nga aksesin e informacionit, i cili sipas ligjit "Për të drejtën e informimit" është i aksesueshëm për publikun

8. Këshilltari duhet të përdorë burimet e Këshillit (nëse Këshilli i jep këshilltarit akses në burime si telefon, kompjuter apo pajisje IT-je) vetëm për të kryer detyrat e Këshillit apo aktivitete të lidhura me të. Këshilltari nuk duhet të përdorë këto burime për qëllime personale të tij apo politike të partisë që i përket. Këshilltari nuk duhet të lejojë që persona të tjerë (pjesëtare të familjes apo miq të tij) të përdorin burimet e Këshillit, vetëm në rastet kur është autorizuar nga Këshilli.

9. Këshilltari duhet të zbatojë ligjin dhe rregulloret e Këshillit në deklarimin e shpenzimeve. Këshilltari duhet të mbajë evidenca të sakta të mbështetura me fatura në të gjitha rastet kur shpenzon fondet e Këshillit. Nëse nuk ka njohuritë e nevojshme apo nuk është i sigurt, këshilltari duhet në çdo rast të këshillohet me Sekretarin e Këshillit.

10. Këshilltari nuk duhet të pranojë dhurata, shërbime apo përfitime, që mund t'i marrë për shkak të pozicionit si këshilltar, për vete apo në emër të të tjerëve, kur vlerëson se marrja e tyre mund të konsiderohet si kompromentim i objektivitetit në marrjen e vendimeve apo i favoreve gjatë ushtrimit të detyrave si këshilltar. Këshilltari nuk ka pse të njoftojë për dhurata që nuk kanë lidhje me funksionin e tij si këshilltar. Si rregull i përgjithshëm, këshilltari duhet të konsultohet me Sekretarin kur ai nuk është i bindur çfarë duhet të deklarojë si dhurata apo favore, pasi kjo është në përputhje me parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë së jetës publike.

11. Këshilltari duhet të sillet dhe veprojë mbi bazën e parimit të barazisë së mundësive, pavarësisht nga gjinia, mosha, raca, feja, orientimi seksual dhe aftësitë e kufizuara të personave. Këshilltari duhet në çdo rast të shmangë diskriminimin, në të 4 format e paraqitjes së tij dhe përkatësisht:

- a) Diskriminimi direkt: trajtimi i njerëzve ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, racës, fesë, orientimit seksual dhe aftësive të kufizuara;
- b) Diskriminimi indirekt: trajtim që në dukje nuk diferencon njerëzit për shkak të gjinisë, moshës, racës, fesë, orientimit seksual dhe aftësive të kufizuara, por që në mënyrë disproporcionale i disavantazhon ata;
- c) Ngacmimi: përfshirja në sjellje të padëshiruara për shkak të gjinisë, moshës, racës, fesë, orientimit seksual dhe aftësive të kufizuara të dikujt, gjë e cila dëmton dinjitetin e tij ose krijon një mjedis negativ, degradues, poshtërues ose ofensiv.
- d) Viktimizimi: trajtimi i një personi në mënyrë më pak të favorshme, kur ai është ankuar për diskriminim ose ka bërë padi për diskriminim.

12. Këshilltari duhet të tregojë respekt dhe konsideratë në trajtimin e të tjerëve. Liria e shprehjes nuk duhet të përdoret si justifikim për sjellje dhe trajtim të papranueshëm për të tjerët, pasi kjo dëmton këshilltarin në sy të publikut. Këshilltari nuk duhet të bëhet objekt i zbatimit të Kodit kur komentet e tij janë të natyrës politike, bën kritikë të ideve dhe opinionëve të palës tjetër politike apo kundërshtarëve politikë, brenda mbledhjeve të Këshillit ose jashtë tij, pasi ato konsiderohen pjesë e debatit demokratik. Këshilltari nuk duhet t'i bëjë këto komente në mënyrë ofensive dhe të papranueshme, apo të bëjë kërcënime ndaj kolegëve këshilltarë apo punonjësve të administratës së Këshillit. Këshilltari duhet të trajtojë kolegët, kundërshtarët dhe punonjësit e administratës së Këshillit me edukatë, mirësjellje dhe konsideratë.

13. Këshilltari nuk duhet të demonstrojë shfaqje të bullizmit ndaj kolegëve këshilltarë, punonjësve të administratës së Këshillit, apo publikut, që mund të rezultojë në bezdisjen ose shqetësimin e tyre përmes sjelljes ofensive, intimiduese, malinje, ofenduese ose poshtëruese.

## **Neni 6**

### **Raportimi i thyerjeve se Kodit**

1. Ankesat për thyerje të Kodit nga ana e një këshilltari mund të bëhen nga një këshilltar, grup këshilltarësh, administrata e Këshillit, ose nga publiku. Është detyrë e çdo këshilltari, kur vëren thyerje të Kodit nga ana e kolegëve të tij, t'i raportojë tek autoriteti përgjegjës.
2. Ankesat për thyerje të Kodit duhet të raportohen tek Komisioni i Përhershëm i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve të Këshillit. Nëse Këshilli nuk ka krijuar një komision të tillë, ankesat bëhen në Kryesinë e Këshillit deri në ngritjen e këtij komisioni nga Këshilli.
3. Ankesat për thyerje të Kodit nuk duhet të kalohen menjëherë në media apo shtypin lokal, para se të kalojnë dhe sqarohen në instancat brenda Këshillit sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij neni.
4. Kodi nuk duhet të përdoret nga këshilltarët për të ngritur ankesa të pabazuara ndaj kolegëve të tjerë, apo për t'u shërbyer qëllimeve të tyre politike ose private. Ankesat nuk

duhet të motivohen nga motive të dobëta të dëmtimit apo të rivalitetit politik, sidomos në periudha fushatash elektorale.

5. Raportimi i thyerjes së Kodit duhet të shoqërohet gjithnjë me prova dhe fakte që mbështesin ankesën. Evidencat mund të përfshijnë minutat e mbledhjeve, korrespondencat dhe shënimet e shkruara, ose e-mailet.

6. Nëse ka individë që kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur thyerja e Kodit, ata duhet të ftohen si dëshmitarë. Kjo është sidomos e nevojshme kur nuk ka evidenca të mjaftueshme që mbështesin thyerjen e Kodit.

7. Këshilltari i akuzuar për thyerje të Kodit duhet të bashkëpunojë me autoritetin përkatës gjatë hetimit, duke vënë në dispozicion menjëherë të gjithë korrespondencën, kopjet e dokumentave që kërkohen, apo dhe duke qenë i disponueshëm për intervistë dhe dëgjesa, nëse kërkohet. Kjo vlen gjithashtu edhe për dëshmitarin nëse ka, dhe nëse autoriteti i hetimit e sheh të arsyeshme.

8. Këshilltari i akuzuar për thyerje të Kodit nuk duhet të ushtrojë presion mbi individin që bën ankesën ose mbi dëshmitarin. Këshilltari nuk duhet të intimidojë apo përpiqet të intimidojë një person që ka gjasa të bëjë një ankesë, një dëshmitar, apo një anëtar të autoritetit që merret me thyerjet e Kodit.

## **Neni 7**

### **Komisioni i Etikës, Standardeve dhe Apelimeve**

1. Autoriteti që merret me thyerjet e Kodit është Komisioni i Etikës, Standardeve dhe Apelimeve, i cili përbëhet nga 5 (pesë) Këshilltarë.

3. Komisioni bën hetimin e duhur dhe ka përgjegjësinë të vendosë nëse këshilltari ka thyer Kodin dhe për pasojë mbi të duhet të veprojë sanksionet.

4. Komisioni i Standardeve duhet të bëjë seancë dëgjimi me këshilltarin e ankimuar para se të japë vendimin.

5. Kur Komisioni i Standardeve konkludon që një këshilltar ka thyer Kodin, ai mund të vendosë për masat e mëposhtme:

a) Asnje veprim, nëse thyerja është e parëndësishme ose e vogël;

b) Vërejtje;

c) Pëzullim në marrjen pjesë në Mbledhjet e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershëm për një periudhë të caktuar në Rregullore.

## **KREU II.**

### **KONFLIKTI I INTERESIT**

#### **Neni 8**

#### **Rastet e Konfliktit të Interesit/ Pengesës ligjore**



1. Kuptimi i konfliktit të interesit konsiston në mbrojtjen e parimeve të interesit të përgjithshëm dhe objektivitetit, në mënyrë që këshilltarët të marrin vendime në mënyrë të drejtë dhe pa paragjykuar çështjet e marra në shqyrtim.

2. Konfliktet e interesit lidhen me çështje në të cilat këshilltari apo ndonjë person i tij i afërt mund të kenë lidhje dhe për pasojë ky interes mund të influencojë vendimmarrjen apo votën si Këshilltar dhe mund të ndikojë në:

a) Punën ose biznesin e këshilltarit;

b) Punëdhënësin e këshilltarit, ose çdo kompani ku ai është partner ose drejtues me pagesë;

c) Një person që ka financuar fushatën elektorale të këshilltarit ose financon shpenzimet e tij si këshilltar;

d) Një kompani ku këshilltari ka aksione;

e) Një institucion në të cilin këshilltari është zgjedhur apo emëruar nga Këshilli;

f) Një institucion publik që ushtron funksione të natyrës publike, një institucion që rol kryesor ka influencimin e opinionit publik, një shoqatë bamirëse, një sindikatë, një shoqatë profesionale, një klub privat, në të cilat këshilltari është anëtar apo është në pozicion menaxherial ose kontrolli të përgjithshëm;

g) Një kontratë që Këshilli bën me një kompani në të cilën këshilltari është partner, drejtor me pagesë ose ka aksione;

i) Një truall i dhënë me qera nga Këshilli një shoqërie ku këshilltari është partner ose drejtor me pagesë;

j) Një truall në territorin e Këshillit për të cilin këshilltari ka një titull pronësie apo është bashkëpronar.

3. Konflikti i interesit të këshilltarit konsiderohet gjithashtu një çështje apo vendimmarrje që ndikon në mirëqënien, standartin e jetesës dhe pozitën financiare të tij, familjes apo të personave të afërt të tij.

4. Këshilltari njofton Kryetarin e Këshillit nëse ka interesa me çështjen që do të shqyrtohet në Mbledhjen e Këshillit. Në këtë rast, Këshilltari nuk merr pjesë në diskutim dhe largohet derisa mbaron procedura e votimit (ligji 8480/ 1999, neni 13/3).

## Neni 9

## **Kushtet e pengesës ligjore për përfshirje në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse**

Këshilltari nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse edhe në rastet kur:

- a) Ka një interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në vendimarrjen në shqyrtim;
- b) Bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në vendimarrjen në shqyrtim;
- c.) Ai ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b” të kesaj pike kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në një çështje objektivist të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;
- d) Ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
- e) Personat e përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike kanë marrë pjesë si eksperte, përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;
- f) Ai ose personat e përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në çështjen në shqyrtim;
- g) Ai ose personat e përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës së shqyrtimit;
- h) Ai ose personat e përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vleresohen, sipas rrethanave konkrete, se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën në shqyrtim;
- i) Ai ose personat e përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike janë përfshirë në mënyra të ndryshme në negociime të mundshme për punësim për vetë këshilltarin apo të personave të përmendur në shkronjën “b” të kesaj pike gjatë ushtrimit të funksionit, apo në negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- j) Në çdo rast që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 10**

**Veprimi kur një Këshilltar ka konflikt interesi/ Kushtet e pengesës ligjore.**

1. Nëse Këshilltari zbulon, përmes kalendarit vjetor të çështjeve të Këshillit, apo rendit të ditës së dërguar para fillimit të një mbledhjeje, që ka një konflikt interesi apo vëren një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 52 të ligjit 139/2015, apo të nenit 7/pika 3, të ligjit 9131/ 2003, ai duhet ta njoftojë me shkrim ose e-maili Kryetarit e Këshillit Bashkiak<sup>1</sup> brenda 14 ditësh. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklarimet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme<sup>2</sup> në proces-verbalin e Mbledhjes së Këshillit ku shqyrtohet çështja për të cilën këshilltari ka pengesë ligjore.

2. Përveç vetë këshilltarit, edhe persona të tretë mund të konstatojnë konfliktin e interesit të një këshilltari dhe për rrjedhojë të kërkojnë përjashtimin e pjesëmarrjes së tij nga një procedurë vendimmarrëse. Kërkesa, me arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi i këshilltarit nga shqyrtimi dhe vendimmarrja, duhet t'i drejtohet Sekretarit përmes një letre ose e-maili dhe të përmbaje të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

3. Kryetari i Këshillit, i njoftuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, i propozon Këshillit përjashtimin ose konfirmimin e këshilltarit nga /në procedura vendimmarrëse e çështjes, për të cilën këshilltari ka apo dyshohet se ka konflikt interesi/pengesës ligjore, kjo si në rastin e Mbledhjet së Këshillit ashtu edhe në mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të Këshillit.

4. Nëse Kryesia e Këshillit vendos përjashtimin e Këshilltarit nga procedura vendimmarrëse, këshilltari nuk duhet të marrë pjesë as në diskutimin e çështjes, por të largohet nga salla porsa të fillojë shqyrtimi i çështjes. Këshilltari nuk duhet të qëndrojë gjithashu në sallë për të ndjekur procesin e votimit.

5. Këshilltari nuk duhet të bëjë përpjekje për të influencuar një vendim të një çështjeje ku ai ka konflikt interesi. Edhe vetë prania e tij në sallë perceptohet si influencim i procesit të votimit, prandaj këshilltari duhet të largohet nga salla në kohën kur shqyrtohet dhe votohet çështja.

## Neni 11

### Regjistrimi i konflikteve te interesit

1. Konfliktet e interesit të këshilltarëve lidhur me çështje të shqyrtuara në mbledhjet e Këshillit duhet të regjistrohen në një dokument të vecantë që quhet Regjistri i

---

<sup>1</sup> (ligji 139/2015, neni52/2)

<sup>2</sup> (ligji 9131/ 2003, nenit 7/3)

Konflikteve të Interesit të Këshilltarëve. Këshilli është i detyruar të mbajë, përditësojë dhe botojë elektronikisht online këtë regjistër. Ai duhet të mbahet nga Sekretari dhe synon transparencën dhe rritjen e besimit të publikut në integritetin e pushtetit lokal.

2. Në Regjistër duhet të deklarohen gjithashtu dhuratat ose shërbimet që mund të marrë një këshilltar në cilësinë si i tillë. Kjo duhet të përfshijë detaje si lloji i dhuratës, personin që e ka dhënë si dhe lidhjen e këshilltarit me këtë person.

### **KREU III**

#### **MASAT DISIPLINORE NDAJ KËSHILLTARËVE**

##### **Neni 12**

1. Rastet e masave disiplinore ndaj këshilltarëve

a) Kur këshilltari nuk respekton kohën e diskutimit, ndërhyt gjatë kohës që flet një këshilltar tjetër ose Kryetari i Bashkisë, apo diskuton jashtë temës, i tërhiqet vëmendja nga Kryetari i Këshillit.

b) Kur këshilltari e përsërit shkeljen në të njëjtën mbledhje, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, i jepet vërejtje nga Kryetari i Këshillit. Vërejtja regjistrohet në proces-verbalin e mbledhjes.

c) Këshilltarit, i cili përdor fjalë jashtë etike, apo pengon me sjelljen e tij zhvillimin normal të mbledhjes, i jepet vërejtje nga Kryetari i Këshillit.

d) Kur këshilltari e përsërit veprimin, kryesuesi i seancës urdhëron dhe i kërkon që të dalë jashtë salle.

e) Në rast se këshilltari nuk pranon të dalë nga salla, kryesuesi i seancës e ndërpret mbledhjen dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë në Këshill për zbatimin e urdhrin të dhënë.

f) Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga këshilltari në mbledhje tërhiqen prej tij në po të njëjtën mbledhje dhe këshilltari kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa disiplinore e dhënë anulohet nga kryesuesi i seancës.

g) Kur këshilltari pengon zhvillimin e rregullt të mbledhjes, prish qetësinë në sallë, nëpërmjet moslejimit të këshilltarit të rradhës të marrë fjalën, për më shumë se 2 minuta, atëherë Kryetari e paralajmëron për marrjen e masës së përjashtimit nga Mbledhja, e në rast se Këshilltari vazhdon të mos lejojë këshilltarin të vazhdojë fjalën edhe pas

paralajmërimin, për më shumë se një minutë, i kërkohet largimi nga Mbledhja në mënyrë vullnetare apo me ndihmën e punonjësve të sigurisë së Mbledhjes së Këshillit.

h) Kur këshilltari bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në mbledhje gjë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon këshilltarët e tjerë, anëtarët e administratës, ose përdor fjalë fyese për Kryetarin e Bashkisë, me urdhër të kryesuesit të seancës përjashtohet nga seanca për atë ditë si dhe kërkohet të ndalohet të marrë pjesë në mbledhjen e rradhës së Këshillit. Ndalimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e rradhës vendoset nga Kryesia e Këshillit me propozimin e Kryetarit ose propozimit me shkrim të jo më pak se 5 këshilltarëve. Mbledhja e Kryesisë zhvillohet brenda 48 orëve dhe këshilltari, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në të për të paraqitur qëndrimin e tij.

2. Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohet mbledhjes, por brenda mjediseve të godinës, procedohet si në piken h të këtij neni.

3. Çdo Këshilltar që largohet pa leje nga salla e Këshillit gjatë mbajtjes së një Mbledhjeje Zyrtare të Këshillit dhe kur kjo shkakton pezullim e mbledhjes apo të votimit, i jepet vërejtje nga Kryesuesi i mbledhjes, përveç rastit kur Kryesuesi lejon largimin. Vërejtja deklarohet nga Kryesuesi në atë mbledhje të Këshillit ku ajo jepet dhe regjistrohet në proces-verbalin e mbledhjes. Leja për t'u larguar nga salla e mbledhjes së Këshillit i kërkohet Kryesuesit në sesion të hapur të Këshillit, pasi arsyeja të jetë bërë e njohur.

4. Këshilltari që thotë fjalë të pahijshme, kapërcen standardet e mirësjelljes dhe etikës gjatë fjalës së tij, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e diskutimeve apo cënon rregullin e mbledhjes, i hiqet vërejtje nga Kryesuesi i Mbledhjes së Këshillit.

## Neni 13

### **Përgjegjësia Ligjore e Këshilltarit**

1. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve nga secili këshilltar, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si këshilltar mund të rezultojnë që ai/ajo të jetë përgjegjës personalisht për dëmet që nuk do të mbulohen nga sigurimi i Bashkisë. Shembuj mund të përfshijnë diskriminim, ngacmim ose mashtrim.

2. Këshilltarët marrin pjesë në trajnime për menaxhimin e rrezikut për të zvogëluar përgjegjësinë për shkak të veprimeve të ndërmarra.

## **Neni 14**

### **Miratimi dhe Hyrja në fuqi**

Kjo Kod miratohet me votimin Pro të shumicës së të gjithë anëtarëve të Këshilli Bashkiak dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike të tij.

\* \* \* \* \*